



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

ALBANIA

PER SHPERNDARJE TE MENJEHERSHME

23 Janar 2008

#A108Y

Zyra e Shtypit: 0692033826

Email: egadeshi@yahoo.com

<http://albania.usaid.gov>

PRESS RELEASE

Një Program i ri i USAID-it me vlerë 7.3 milionë dollarë për Përmirësimin e Rritjes Ekonomike dhe Qeverisjes Vendore në dhjetë Bashki

TIRANE – Ceremonia e firmosjes së Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) midis USAID-it dhe kryetarëve të 10 bashkive pjesëmarrëse në 23 Janar shënoi edhe fillimin e programit të ri 4-vjeçar prej 7,3 milionë dollarësh të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA). Drejtori i Misionit të USAID-it, Edward T. Landau dhe Kryetarët e Bashkive të Fierit, Fushë Krujës, Gramshit, Himarës, Korçës, Kukësit, Lezhës, Librazhdit, Pogradecit dhe Shkodrës firmosën Memorandumet e Mirëkuptimit për të përvijuar asistencën e USAID-it.

Projekti LGPA i USAID-it synon të përmirësojë qeverisjen në bashkitë e përzgjedhura si dhe të ndërtojë partneritete publik-privat për të krijuar një ambient miqësor ndaj biznesit të brenda të cilit të zhvillohet më tej sektori privat vendor. Aktivitetet e USAID-it do të kërkojnë të rrisin investimet, të krijojnë vende të reja pune, të rrisin të ardhurat si dhe të zgjerojnë bazën e taksave të bashkive.

Në fjalën e tij drejtuar kryetarëve të bashkive, Drejtori i Misionit Landau, theksoi: “Gjatë dekadave të kaluara asistencë e USAID-it ka ndihmuar në drejtim të krijimit të bazës ligjore dhe aftësive teknike të nevojshme për decentralizimin e pushtetit të qeverisjes qendrore drejt bashkive. Tashmë, nëpërmjet rritjes ekonomike lokale, projekti LGPA do të tentojë të gjenerojë të ardhura nga taksat si dhe mjete të tjera financiare që bashkitë do të kërkojnë për të ushtruar pushtetin e tyre.”

Këto dhjetë bashki u zgjodhën pas marrjes në konsideratë të kapaciteteve të tyre fiskale, normës së rritjes së biznesit të vogël si dhe të interesit që ata shprehën në drejtim të përmirësimit të niveleve të ofrimit të shërbimeve publike nëpërmjet një procesi zhvillimi transparent dhe gjithëpërfshirës.

Baza e programit do të jetë krijimi i një Komiteti të Rritjes Ekonomike të Bashkisë në secilin prej qyteteve. Me një pjesëmarrje bi-partizane nga sektorët publik, privat dhe të shoqërisë civile, këto komitete do të hartojnë një vision strategjik të zhvillimit të ardhshëm ekonomik për komunitetet e tyre si dhe do të përcaktojnë prioritetet në lidhje me veprimet e menjëhershme të tilla si përmirësimi i shërbimeve publike, procedurat e mbledhjes së taksave dhe sistemet e menaxhimit të aseteve. Nëpërmjet këtyre planeve projekti LGPA do të punojë me secilën prej bashkive pjesëmarrëse për të identifikuar dhe tërhequr investitorët potencial.

Gjatë ceremonisë që u zhvillua në Hotel Tirana International ishin të pranishëm gjithashtu edhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit lokal nga secila bashki.

###